

NEWSLETTER

Shkurt

**Boom Ofertash
për Sigurimin
e Banesave Online
në Albsig**

**Karta e Studentit me
mbi 40 Shërbime,
Lehtësira edhe
nga Shoqëria
e Sigurimeve Albsig**



PJESË E  KASTRATI GROUP

**Bli Online
Sigurimin e Shëndetit
në Udhëtim në
Albsig dhe Merr
30% Ulje**

**Produktet dhe
Shërbimet e Albsig
më të Përzgjedhurat
në Treg nga Shqiptarët**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Muaji Shkurt, Boom Ofertash për Sigurimin e Banesave Online në Albsig

Dashuria është në ajër, por fletë e ka në tokë! Bli Sigurimin e Pronës dhe përfito kartën e shëndetit Albsig Med FALAS. Bli online nëpërmjet website-it të Albsig dhe dhuratat në muajin e dashurisë nuk kanë fund. Muaji Shkurt është cilësuar si muaji me më shumë oferta nga Albsig, por ndryshe nga herët e tjera ofertat janë për ata që blejnë produktet e Albsig online. Tani online mund të bleh shumë produkte, por këtë muaj fokusi do të jetë tek Sigurimi i Shtëpisë, Sigurimi i Makinave dhe Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim. Edhe pse Sigurimi i Banesës është shumë më i rëndësishëm se sigurimi i një automjeti, lihet në dorë të situatës.

Nëse ti shkon në bankë për të marrë një kredi dhe banka të detyron ta sigurosh, e siguron. Përndryshe, është një numër shumë i vogël vullnetar që sigurojnë banesat. Për të sensibilizuar sadopak dhe për të rritur numrin e atyre që bëjnë sigurimin vullnetar të apartamenteve, Albsig ka hapur siparin e ofertave online. Klientëve të tij dhe jo vetëm, Albsig u mundëson sigurimin e banesave online edhe pse shqiptarët duket se nuk e kanë kulturën e nevojshme për të bërë këtë sigurim në mënyrë masive. Ndërsa, sa i përket anës financiare nuk është kryesor faktori ekonomik sepse sigurimi i një banese kushton shumë pak po të marrin parasysh vlerën që ajo mbulon.



Sipas të dhënave të sapopublikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, këtë Janar janë rritur si numri i subjekteve që kanë siguruar pronat, ashtu edhe volumi i parave që është paguar për këtë qëllim. Në portofolin Sigurimi nga Zjarri dhe Forcat e Natyrës, gjatë muajit Janar 2023, vihet re një rritje prej 23.84% e vëllimit të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli dhe një rritje me 13.95% e numrit të kontratave të sigurimit, krahasuar me periudhën Janar 2022. Nga diçka më pak se 1 milionë dollarë në Janarin e vitit të shkuar, muajin e parë të këtij viti janë paguar mbi 1.2 milionë dollarë për këtë qëllim.

Rritja është e dukshme duke ju referuar shifrave modeste me të cilat u mbyll viti 2022 sa i përket këtij portofoli. Përgjatë gjithë vitit të shkuar u paguan në total nga shqiptarët rreth 18 milionë dollarë për sigurimin e pronave nga zjarri e fatkeqësitë, rreth 1 milionë dollarë më shumë se në vitin 2021. Rritja sipas ekspertëve është modeste duke parë fatkeqësitë e shumta natyrore me të cilat janë përballur së fundmi shqiptarët, duke nisur nga tërmetet, te zjarret, e deri te përmbytjet, të cilat u rikthyen vitin e shkuar. Sa i përket tregut të sigurimeve në total, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën Janar 2023 kapën vlerën 1,712 milionë lekë, ose 20.6% më shumë se në Janar 2022. Gjatë muajit Janar 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 96,527 me një rritje prej 15.19% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Bli Online Sigurimin e Pronës

Përfitoni Albsig Med
FALAS

Emër _____	Nr. ID _____
Mbiemër _____	Vlefshmëria _____

20% - 35%
ulje në analiza & vizita
mjekësore

10%
ulje në ndërhyrje kirurgjikale



**Albsig
MED**

 albsig.al



BLI ONLINE

Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim në Albsig dhe Merr 30% ULJE

Këtë Shën Valentin shprehuni të dashurve tuaj dashuri dhe siguri. Për të gjithë ju që këtë festë të shenjtë keni vendosur ta festoni jashtë vendit, Sigurimin Shëndeti në Udhëtim e përfitoni me 30% ulje nëse e blini Online. Bli tani në www.albsig.al dhe përfito ulje në mënyrë të menjëhershme, për çiftet e reja dhe për çdo grup udhëtarësh që ka planifikuar të festojë në muajin e dashurisë.

Viti 2022 ka shtuar optimizmin dhe dëshirën për të udhëtuar jashtë vendit pas një periudhe të gjatë kufizimesh në lidhje me pandeminë. Shtimi i vaksinimeve dhe lehtësimi i kufizimeve në shumë vende të botës ka bërë përsëri të mundur planifikimin e udhëtimeve të biznesit dhe ato turistike për individët ose familjet. Sidoqoftë, udhëtimi jashtë vendit nuk është pa rreziqe dhe çdo udhëtar shqiptar duhet të marrë masa për të mbrojtur veten nga humbje financiare të paparashikuara, për të papritura shëndetësore gjatë qëndrimit në një vend të huaj. Bashkë me vaksinimin dhe masat mbrojtëse ndaj Covid, siguri i shëndetit në udhëtim është një tjetër element thelbësor për të garantuar përvojën më të mirë kudo që të ndodheni.

Polica Albsig ju Shoqëron në të Gjithë Globin

Mund të jeni dashamirës sportesh ekstreme, i apasionuar pas ecjeve të gjata në natyrë apo thjesht admirues arkitekture dhe arti. Jeni me shërbim pune dhe nxitoni të bëni gjithçka brenda kohës së kufizuar të qëndrimit, apo jeni një familje që keni planifikuar një larmi aktiviteteve argëtuese. Cilido qoftë qëllimi i udhëtimit tuaj, Albsig bën të mundur që shëndeti dhe kuleta juaj të jenë në duar të sigurta kudo që të shkoni. Me një mbulim deri në 10,000 Euro, polica e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim Albsig, shmang çdo humbje financiare nga sëmundje akute, aksidente apo riatdhesime urgjente, duke ju mundësuar të kërkonte shërbim mjekësor.

Urgjencat Shëndetësore të Rimbursueshme

Sigurisht që askush nuk ka dëshirë të mendojë më të keqen kur niset për një eksperiencë të bukur. Të gjithë do të preferonim ta shpenzonim kohën e përgatitjeve duke planifikuar sa më shumë zbavitje. Blerja e një police udhëtimi mund të duket e bezdisshme pasi mendon se gjasat që të të ndodhë diçka e keqe në atë pak ditë janë shumë të pakta dhe mendon se mund të mjaftohesh duke e blerë për ta pasur në xhep në pikat e kontrollit gjatë rrugës. Por shpesh herë dhe veçanërisht për shqiptarët, buxheti është mjaft i kufizuar, ndaj në rast të një urgjence të papritur mjekësore, gjendeni në një situatë që mund të jetë financiarisht e papërbalueshme, me Policën e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim Albsig, nuk do të keni nevojë të vononi kujdesin mjekësor që ju nevojitet.

Mbrojtje nga Aksidentet – Të Kujdesshëm dhe të Përgjegjshëm

Çdo udhëtar niset me dëshirën për të krijuar çaste të paharrueshme, për të përjetuar aventura mbresëlënëse dhe secili zgjedh destinacionin e tij duke planifikuar në detaj çdo aktivitet argëtues, takim biznesi, apo vizitë tek miqtë dhe familjarët. Por si mund të planifikoni për aksidente që mund të ndodhin kudo dhe kurdo sado të kujdesshëm të tregoheni dhe në çast, ta gjeni veten të mbetur ngushtë në një vend të huaj? Frika nga të papriturat fatkeqe mund të errësojë edhe përvojën më të paharrueshme. Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim Albsig, ju shpëton nga ankthi i pasigurisë duke ju mundësuar ndihmën mjekësore dhe riatdhesimin në rast emergjence.

Saktësia e Dokumentacionit – Kusht Themelor

Keni zgjedhur destinacionin tuaj, keni planifikuar kohën e udhëtimit, keni rezervuar biletat, hotelin dhe keni piketuar vendet ku do të shkoni, restorantet që doni të provoni, madje edhe dyqanet ku do të bëni pazar. Keni shpenzuar gjithë kohën e nevojshme për t'i siguruar vetes dhe të dashurve tuaj përvojën dhe kushtet më të mira. Tani është koha të mendoni për t'u mbrojtur nga rreziqet dhe problemet e papritura që mund të prishin gjithçka. Zgjedhja e sigurimit në udhëtim dhe mirëinformimi mbi kushtet dhe udhëzimet e nevojshme që përmban polica juaj, është mbrojtja që ju duhet për të shijuar çdo çast pa shqetësim dhe frikë, por jo vetëm kaq. Mirëinformimi dhe saktësia e dokumentacionit janë themelore për vlefshmërinë e policës suaj të sigurimeve, ndaj kushtojini kohën dhe vëmendjen e duhur pa anashkaluar asgjë.

Masat që Duhet Marrë për të Përfitur nga Polica e Sigurimit

Jeni duke shijuar udhëtimin tuaj të lumtur që më në fund jeni larguar nga stresi i përditshëm, lodhja dhe mjedisi monoton që shihni çdo ditë, ose keni shkuar për një takim pune të rëndësishëm? Papritur, ndodh ajo që nuk e prisnit dhe ju duhet të menaxhoni në kohë rekord një situatë të vështirë, në një vend të huaj. Jeni pajisur me policën e sigurimit të shëndetit në udhëtim dhe jeni të qetë, por duhet të kujdeseni që të ndiqni hapat e nevojshme për të përfitur siç duhet prej saj. Ja cilat janë disa nga masat kryesore që duhen marrë për të plotësuar kushtet e përfitimit nga polica juaj e udhëtimit:

- Merrni me vete të dhënat dhe numrat e kontaktit të policës së sigurimit dhe numrat e emergjencës.
- Nëse ndodh diçka gjatë udhëtimit, ruani faturat për gjithçka që ju duhet të paguani, që të mund të kërkonti dëmshpërblimin.
- Nëse është e mundur, kontaktoni me kompaninë e sigurimit përpara trajtimit mjekësor. Në rast pamundësie, njoftimi duhet të bëhet brenda 34 orëve.
- Sigurohuni që kërkesa për dëmshpërblim të bëhet brenda 10 ditëve nga kthimi në shtëpi.

Rastet kur Kërkesa për Dëmshpërblim Refuzohet

Është e rëndësishme të mos nënvlerësoni asgjë kur është fjala për të siguruar shëndetin në udhëtim. Ju mund të niseni të qetë drejt destinacionit dhe në rastin e një situatë të vështirë, shpenzoni deri në qindarkën e fundit të bindur se do të dëmshpërbleheni me të mbërritur në shtëpi. Por nuk ndodh gjithmonë kështu. Nëse s'merrni masat e duhura, kthimi në atdhe do t'ju përballë me një situatë edhe më të vështirë nga e cila mund t'ju duhet shumë kohë ta merrni veten. Më poshtë janë disa nga arsyet kryesore për të cilat mund t'ju refuzohet mbulimi i shpenzimeve në udhëtim:


- Mungesa e informacionit të saktë dhe të vërtetë në dokumentacion
- Sëmundje ekzistuese të padeklaruar
- Mangësi në faturat origjinale të shpenzimeve

Albsig – Shoku i Duhur në Udhëtim

Tarifat e policave të udhëtimit nuk janë aspak të kushtueshme, por mund të të kursejnë shuma të mëdha parash. Është vërtet një bezdi e vogël që të mbron nga telashe të mëdha dhe kur zgjedh një policë siguri Albsig, përfiton më shumë se një mbulim standard. Albsig ofron tashmë edhe mundësinë e blerjes online të policës suaj, duke ju lehtësuar më shumë mbrojtjen nga të papriturat gjatë udhëtimit. Polica e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim Albsig do të thotë gjithashtu besim se çdo nevojë do të gjejë përgjigjen dhe zgjidhjen e duhur në kohë rekord. Shërbimi korrekt, integriteti dhe profesionalizmi i Albsig, ju bën të ndiheni të sigurt që në çastin e parë.



Bli Online





KARTA E STUDENTIT ME MBI 40 SHËRBIME, LEHTËSIRA EDHE NGA SHOQËRIA E SIGURIMEVE ALBSIG

Prej 3 muajsh, Melani Lleshi studente në vitin e parë në Fakultetin e Gazetarisë, është pajisur me kartën e studentit. Por, sa e vlefshme ka qenë kjo kartë për Melaninë?

“Nuk është se më ka shërbyer shumë, thjesht më ka shërbyer për t’u regjistruar në bibliotekën e lagjes.” – u shpreh studentja. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Bashkisë së Tiranës, studentët përfitojnë mbi 40 shërbime dhe lehtësi të tjera. Vendosëm që bashkë me Melanine të shkojmë nëpër disa prej institucioneve shtetërore dhe private, që përfshihen në listën ku studentët përfitojnë shërbime. Fillimisht ndalemi në BunkArt, ku studentët përfitojnë ulje çmimi me 20%. “Nga 500 lekë që ishte çmimi, e përfitova me 300 lekë.” – tha ajo dhe kjo ulje ishte ashtu siç shkruhej në letër. Më pas te “Shtëpia e Gjetheve”, ku biletën e përfiton me 70 % ulje. “Një ndër vendet ku ne sipas kartës përfitojmë ulje është edhe Shtëpia e Gjetheve. Nga çmimi 700 lekë e përfitova 210 lekë.” – thekson studentja.

Ulje të çmimeve studentët përfitojnë edhe në disa subjekte private, por a u shërben kjo studentëve dhe a janë në dijeni të të gjitha mundësive që kanë me praninë e kartës?

“Është qesharake sesi mund të na ofrojnë ulje në dyqane ku ne si student as nuk mund të futemi për të parë, jo më për të blerë diçka. Ulja që ne përfitojmë është shumë e vogël. Na është thënë se kemi mundësi ulje çmimesh edhe ne sigurime. Për ne është e rëndësishme se përveç sigurimit të makinave që është për prindërit, përfitojmë dhe ne sigurimet shëndetësore.” – theksoi studentja gjatë bisedës.

Në listën e zbritjeve janë një sërë produktesh dhe shërbimesh që studentët mund të përfitojnë në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig. Ndërkaq, sipas studentëve, pavarësisht uljeve që janë bërë për ata, përfitimi përmes kartës mbetet vlerë e ulët.

Për Melaninë, karta duhet të përfshinte disa pika të tjera. – “Do të doja të kishim ulje në ndonjë kafe ose në disa mensa, ku ne si studentë të kishim mundësi të hanim të paktën një vakt me çmim më të ulët.” – thotë vajza.

PRODUKTET DHE SHËRBIMET E ALBSIG MË TË PËRZGJEDHURAT NË TREG NGA SHQIPTARËT



Të fokusuar nga vizioni ynë për të qenë partneri juaj i besuar edhe për vitin 2023.

Aktualisht, përveç rritjeve në treg, shoqëria ka investuar në brandimin e markës Albsig, zgjerimin e gamës së produkteve, veçanërisht rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj klientëve. Krahas brandimit dhe forcimit të markës, shoqëria ka zgjeruar dhe modernizuar shërbimet në çdo pikë shitje është investuar gjerësisht dhe në përmirësimin e shërbimeve online. Njëkohësisht Albsig ka synuar dhe synon të ofrojë zgjidhje më të thjeshta, të cilat do të mund të përdoren lehtësisht nga klientët e Albsig në çdo kohë, 24 orë në 7 ditë të javës. Që prej themelimit, Albsig është ndër të paktat shoqëri në tregun e sigurimeve që ka ruajtur vazhdimisht një trend pozitiv në rritje dhe që vit pas viti ka konsoliduar pozitat në tregun e sigurimeve. Sigurisht, kjo rritje e vazhdueshme është dhe rezultat i investimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati. Të dhënat statistikore të Albsig për muajin Janar 2023, ku kryeson në vend të parë në këto produkte.

Dëmshpërblimi në kohë dhe kundrejt procedurave të rregullta dhe në favor të klientit. Këtë proces të munguar dhe të trashëguar nga historiku i sigurimeve ndër vite tashmë e gjeni vetëm në Albsig. Këtë proces transparent dhe në favor të klientit, tashmë prej më shumë se tre vitesh, e hasim dhe e përfitojmë në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig sh.a. Ky proces ka ndikuar jo vetëm te klientët, por ka reflektuar dhe në arritjet e shoqërisë për periudhën e deritanishme. Dëmet e vogla, minimalja 3 ditë e kanë periudhën e ekzekutimit dhe mbylljes si çështje, ndërsa dëmet e tjera me vlera të konsiderueshme shkojnë mesatarisht deri në 30 ditë. Ditët mesatare janë të përllogarituara për Sigurimin Kasko, meqë dhe Albsig kryeson tregun me këtë produkt.

Nga statistikatat e publikuara nga buletini i AMF-së, Albsig sh.a. është përzgjedhur si shoqëria me përgjegjshmërinë më të lartë për shërbimet ndaj konsumatorëve. Tashmë, është cilësuar prej vitesh lider në dëmshpërblim.

Ndërkaq, përsa i përket totalit të shitjeve për muajin janar 2023, 60.05% ka raportin më të lartë në treg për Sigurimet Vullnetare. Ky është një ndër detajet kryesore që Albsig është shpallur shoqëria lider për edukimin e konsumatorëve kundrejt produkteve vullnetare. Po për muajin Janar 2023, 38.89% të tregut zë Sigurimi KASKO, pasuar me 36.63% të tregut Përgjegjësia e Ndërtuesit, 48.44% të tregut Sigurimi i Garancive.



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL